

URDHËR
Nr. 2, datë 6.1.2020

PËR DELEGIM TË KOMPETENCAVE

Në zbatim të nenit 28 dhe nenit 29, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të VKM-së nr. 58, datë 29.1.2004, “Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, neni 26 i Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 1, datë 14.1.2015, “Për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave që lidhen me procedurat e verifikimit të sigurisë së individëve që aplikojnë për CSP dhe operatorëve ekonomik që aplikojnë për CSI, z. Mark Ndreca me detyrë, Drejtori i Drejtorisë së Vetting-ut dhe Sigurimit Industrial.
2. Autorizoj z. Ndreca të kryejë veprimet si më poshtë:
 - a) të firmosë shkresat drejtuar autoriteteve verifikuese për verifikimin e sigurisë;
 - b) të firmosë shkresat me të dhënat e operatorëve ekonomikë të certifikuar përshtatshmërisht drejtuar autoriteteve kontraktore;
 - c) të firmosë shkresat për përditësimin e rekordeve të operatorëve ekonomikë të certifikuar përshtatshmërisht drejtuar autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë;
 - d) të firmosë shkresat përcjellëse për dërgimin e CSP tek institucionet shtetërore.
3. Ky urdhër do të jetë në fuqi deri më datë 31.12.2020.
4. Z. Ndreca nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.
5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet z. Mark Ndreca, Drejtor i Drejtorisë së Vetting-ut dhe Sigurimit Industrial; dhe Arkiv-Protokolli i DSIK-së.
6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR
Dorian Tola